



Emri i Dorëzuar Name - Provided Received Delivery	13.05	2022	2	viti god year
Organ Nivisi Organ Judicial Org Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SK/M8/HCK	2800/2022		113	

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.314/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani anëtar, me Zyle Millaku-Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.314/2022 të datës 30.03.2022 të parashtruar nga ankuesi

Prishtinë Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 13.05.2022, mori këtë;

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent për të vendosur** për ankesën me numër A.nr.314/2022 e datës 30.03.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi ka qenë i punësuar sipas Kontratës së punës për shërbime konsulente me numër protokolli 1200 të datës 24.03.2021 me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/përkatësisht Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, sipas Marrëveshje së lidhur në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Projektit të Bankës Botërore në pozitën "Konsulent në Zyrën Rajonale në Mitrovicë", me afat të caktuar deri me datë 30.06.2021. Po ashtu me date 16.07.2021 sipas kontratës me numër protokolli 2944 ankuesit i është vazhduar angazhimi i punës për ofrimin e shërbimeve shërbime konsulentë nga data 01.07.2021 deri me date 30.12.2021.

Me Vendimin Nr.07/4-6516 ankuesi është angazhuar që të punojë gjatë vikendit në Zyrën Rajonale në Prishtinë, me orar shtesë për të cilën periudhë nuk i është bërë pagesa për periudhën e punës nga data 01.11.2021 deri me datë 03.12.2021, pasi që i njëjti ka qenë në arrest shtëpiak sipas Vendimit nr.PPPS.NR.47/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, nuk ka parashtruar kërkesë për pagesën e orëve gjatë vikendit të pa paguara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore, siç janë paguar zyrtarët e tjerë, i cili me datë 30.03.2022 ka parashtruar ankese tek Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë për kompensimin e shtesës për punë jashtë orarit, me numër protokolli 1513.

Ankuesit deri me tani nuk i është bërë pagesat e orëve të punës gjatë vikendit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me datë 30.03.2022, ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokolli 1699/2022, me pretendime ankimore për



mos pagesën e orëve të punës shtesë për periudhën e punës nga data 01.11.2021 deri me datë 03.12.2021 sipas Vendimin Nr.07/4-6516 të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të pranuar me datë 136.04.2022 me shkresat e bashkangjitura për çështjen juridike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova : Ankesën e datë 30.03.2022 nr. Protokolli 1699/22 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbime Civile të Kosovës; Kobtarë e punës nr.1200 për shërbime konsulentë të datës 24.03.2021; Amendament-imi i kontratës Nr.KARP-CS-42 e datës 16.07.2021, për Projektin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. i kreditë IDA 60170; Evidenca e vijimit në punë e datë 12.11.2021; Evidenca e vijimit në punë e datë 13.11.2021; Evidenca e vijimit në punë e datë 20.11.2021; Evidenca e vijimit në punë e datë 27.11.2021; Fletëlëshim i datës 03.01.2022 i Shërbimit Korrektues i Kosovës; Përgjigje në Ankesë e datës 13.04.2022; E-mail i datës 06.04.2022 kërkesë për aprovim; Kërkesë për aprovim i datës 06.04.2022 nr. 1614; Ankesa e ankuesit drejtua tek Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë për kompensimin e shtesës për punë jashtë orarit, me numër protokolli 1513; Kërkesë për aprovim i datës 09.12.2022 me nr. 6957; Kërkesë për aprovim i datës 01.12.2021 me nr. 6815; Vendim nr.2070 i datës 23.04.2021 për transferim të përkohshëm ; Vendim nr.6136 i datës 08.10.2021 për transferim të përkohshëm; Vendim nr.4347 i datës 29.10.2021 për angazhim shtesë ; Gjendja aktuale e hyrje/dalje e datës 30.10.2021; Vendim nr.4413 i datës 04.11.2021 për kompensim; Gjendja aktuale e hyrje/dalje e datës 06.11.2021; E-mail i datës 0.11.2021; Gjendja aktuale e hyrje/dalje e datës 13.11.2021; Vendim nr.4673 i datës 19.11.2021 për angazhim; Gjendja aktuale e hyrje/dalje e datës 20.11.2021; Email i datës 26.11.2022; E-mail i datës 27.11.2022; Gjendja aktuale e hyrje/dalje e datës 27.11.2021; Kërkesë për pagesë e datës 30.11.2021 nr.6770 me listën e zyrtareve nga data 13.11.2021-Vendim nr.6516 i datës 12.11.2021; 27.11.2021; E-mail i datës 13.04.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës **nuk është kompetent** për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi **sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi marrëdhënien punës e ka themeluar, sipas Kontratës së punës për shërbime konsulente me numër protokolli 1200 të datës 24.03.2021 me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/përkatësisht Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, sipas Marrëveshje së lidhur në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Projektit të Bankës Botërore në pozitën "Konsulent në Zyrën Rajonale në Mitrovicë", me afat të caktuar deri me datë 30.06.2021, dhe e vazhduar deri me date 30.12.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbime Civile të Kosovës, nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën e datës 30.03.2022 të ankuesit sepse ankuesi ka qenë i angazhuar në pozitën "Konsulent në Zyrën Rajonale në Mitrovicë", sipas Kontratës së punës me numër protokolli 1200 të datës 24.03.2021, për ofrimin e shërbimeve konsulente tw lidhur me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë, sipas Marrëveshjes së lidhur në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Projektit të Bankës Botërore, dhe rrjedhimisht në rastin konkret ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil, ashtu siç e përcakton dispozita ligjore e nenit 2 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku është përcaktuar se: "Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e



Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë. Duke u bazuar ne faktet e lartcekura, Kolegji vlerëson së pozita "Konsulent në Zyrën Rajonale në Mitrovicë" nuk konsiderohet pozitë e nëpunësit civil, andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli shqyrton dhe merr vendime për *ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil*, si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil apo të kandidatit për pranim në shërbimin civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.314/2022 të datës 30.03.2022 të parashtruar nga ankuesi.

Kështu që, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.Nr.314/2022.

Zyle Millaku-GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë,
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.

